


KLSH merr pjesë në takimin e 17-të të Grupit të Punës IT të EUROSAI (ITWG)

Në datë 24-25 shtator u organizua në Oslo takimi i 17-të i Grupit të Punës të IT të EUROSAI (IT Working Group), në bashkëpunim të ngushtë midis SAI-ve të Estonisë dhe Norvegjisë. Takimi u zhvillua në formë hibride (me prezencë fizike dhe virtuale).

Gjatë takimit të 17-të, i cili zgjati 2 (dy) ditë, u zhvillua seminari me temë: “Auditori inteligjent në një shtet inteligjent artificial (të auditosh IA)”, i aksesueshëm për të gjithë anëtarët e INTOSAI-t. Seminari u trajtua me një qasje të dyanshme: auditimi i zgjidhjeve të bazuara në Inteligjencën Artificiale, si dhe përdorimi i kësaj teknologjie brenda SAI-ve.



Gjatë prezantimeve nga ekspertë të ndryshëm të SAI-ve, u paraqitën të dhëna për mundësitë dhe risqet, si dhe rastet e përdorimit praktik të Inteligjencës Artificiale (IA).

Disa nga temat e trajtuara në këto prezantime ishin:

- Qasja e qeverisë Norvegjeze ndaj IA;
- Përdorimi i IA në qeverisje – prespektiva Britanike;
- Implikimet e politikave Europiane të IA në qeverisje dhe auditim - SAI Slloveni;
- Auditimi paralel mbi IA- SAI Izrael;
- Raste përdorimi të AI dhe sfidat që vijnë me to - SAI Gjermani;
- Implementimi i një mjeti (tool) IA për auditim bazuar në LLM (large language models)- SAI Francë;
- Auditim financiar inovator me IA;
- AI në auditim - SAI Zvicër.



Takimi i Biznesit i ITWG (IT Working Group) i planifikuar gjatë ditës së dytë të organizimit ishte i rezervuar për anëtarët dhe partnerët bashkëpunues, në mënyrë që të diskutohej mbi projektet e vazhdueshme dhe të planifikuara të ITWG. Ky takim u realizua në formën e workshopit ku pjesëmarrësit (fizikë dhe virtual) u ndanë në grupe dhe diskutuan mbi tre çështje të rëndësishme:

1. Shembuj të përdorimit të Inteligjencës Artificiale;
2. Sfidat unike të auditimit të Inteligjencës Artificiale;
3. Qëllimi i përdorimit të IA në programet trajnuese.

Pjesëmarrësit virtual të takimit duke shfrytëzuar elementët e plotë të platformës ZOOM mundën t'i përgjigjeshin disa pyetësorëve (polls) virtualisht, mbi përdorimin e Inteligjencës Artificiale në shtetet e tyre, politikat rregullatore, fushat në të cilat ka nisur përdorimi i Inteligjencës Artificiale, etj. Kjo pjesë u përmbyll me prezantimet nga SAI-t: Portugali, Zvicër dhe Gjermani.

KLSH në cilësinë e SAI-t anëtar të këtij grupi pune u përfaqësua nga Klea Saliu dhe Arjola Muçaj audituese në Departamentin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.